



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. 2-D/DPK Nr. I faq. Broj stranica Nr. pages 02	Nr. Prot. Br. Prot. 01-2679/14 Prot No. Data Datum 18-07-2014 Date



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 19 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 01/2014 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 14.07.2014, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-2005/14, për z. Enver Kamishi – Drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës në Komunën e Kaçanikut, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funksionit Publik, nr. AKK – 03-2005/14, për z. Enver Kamishi – Drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe Kulturës në Komunën e Kaçanikut, dhe njëkohësisht person i autorizuar në biznesin privat N.P.SH. “EURO-PAK”, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik.

Zyrtarit të lartë z. Kamishi, së pari i është bërë shkresa zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, për njoftimin e fillimit të procedurës së shqyrtimit të gjendjes së Konfliktit të Interesit. Pas pranimi të kësaj shkrese, ai është takuar me zyrtarët e Agjencisë dhe i është sqaruar situata në të cilën ndodhet dhe për ndryshimet që duhet t'i bëj.

z. Kamishi, ka pranuar rekomandimin e Agjencisë për të autorizuar një person të besueshëm për të udhëhequr biznesin privat, në mënyrë që të shmanget situata e mundshme e konfliktit të interesit.

Ndërkohë, i njëjti ka dërguar në Agjencinë kundër Korrupsionit shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI 03 - 2577/14) me të cilën dëshmohet se në

biznesin privat N.P.SH. "EURO-PAK", ka autorizuar një person të besueshëm për të menaxhuar. Me këto ndryshime, zyrtari i lartë z. Enver Kamishi, ka shmangur gjendjen e konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Në pajtim me nenin 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik;
- Drejtorit të DPK- së;
- Z./znj. (zyrtarit përgjegjës).

Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

Hasan Preteni

